



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.603/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada Glllogjani dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Rita Bala nga Gjakova, kandidate për asamble të Kuvendit Komunal në Gjakovë, nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me tërheqjen nga lista si kandidate për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021, në seancën e panelit të mbajtur me 22.09.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET i pasafatshëm apeli Anr.603/2021 i datës 20.09.2021, i parashtruar nga Rita Bala, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal të Gjakovës, nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me tërheqjen nga lista e kandidatëve për anëtare të Kuvendit Komunal të Gjakovës, për pjesëmarrjen në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 17 Tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 20.09.2021 PZAP-i ka pranuar një apel nga Rita Bala nga Gjakova, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal të Gjakovës, me të cilin kërkon tërheqjen nga lista e kandidatëve për anëtare të Kuvendit Komunal të Gjakovës, krejt kjo duke pasur parasysh rrethanat e krijuara: shëndetësore, familjare e personale që lidhen me punësimin, kërkon që të urdhërohet KQZ-ja ta miratoj kërkesën e saj për tërheqje.

PZAP-i me datën 20.09.2021 ka dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kërkesën për përgjigje ne ankesë.

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike ZRPPC - KQZ ka dërguar përgjigjen në ankesë më datën 20.09.2021, në të cilën theksohet se në lidhje me kërkesën për përgjigje, mund të ju informoj që nuk ka ndonjë procedurë që do të mund të aprovonim ndonjë kërkesë për tërheqje nga lista e kandidateve sepse lista e kandidateve të certifikuar është

finale, fletëvotimet dhe formularët e rezultateve janë në proces të shtypjes, ndërsa votimi përmes postës tashmë ka filluar.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së apelit, gjeti se:

Apeli është i pasafatshëm

Paneli pas vlerësimit paraprak të apelit, ka gjetur se apeli i parashtruar nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal të Gjakovës, nga radhët e Nismës Socialdemokrate Rita Bala, paraqitur për tërheqje nga lista e kandidatëve për anëtare të Kuvendit Komunal të Gjakovës është i pasafatshëm.

Paneli ka gjetur se apeli i paraqitur është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën 28 par. 1 të LZP-së, ku përcaktohet: *“Subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ-së një njoftim me shkrim me të cilin shpreh qartazi qëllimin për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit për zgjedhje, të përcaktuar sipas nenit 24.1 të këtij ligji.”* Në këtë rast KQZ-ja e ka tërhequr shortin për renditjen e subjekteve politike në fletëvotim me datën 08.09.2021 ndërsa apeli për tërheqje nga lista është paraqitur në PZAP me datë 20.09.2021, që rezulton të jetë pas afatit ligjor konform nenit 28, paragrafit 1 të LZP-së.

Nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 115 paragrafi 1, nenit 118 dhe nenit 28 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A.nr. 603/2021 më datën 22.09.2021.



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.